

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

04.03.2025
Ora 11:07

RENDI I DITËS

Projektakti “Për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. I. Osmanaj**


• **Parti Politike:** **PD(z. F. Nuri), PS(znj.E.Xhina)**

• **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rendin e ditës shqyrtimin e projektvendimit për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje. Vlerësimin e raportit për veprimtaritë publike për institucionet shtetërore, për periudhën 23 Shkurt- 1 Mars. Vlerësimin e monitoruesit të fushatës zgjedhore po për këtë periudhë. Kemi shqyrtimin e denoncimeve të Partisë Demokratike nr.7, nr.22, nr.23, nr.25, nr.27, nr.28 dhe të KRIIK nr.24. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike gjatë zgjedhjeve.

Znj. P. Doçaj: Po faleminderit! Në mënyrë të përmbledhur kemi sjellë përpara jush për vlerësim, aktin për rregulla të përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online


**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

nga institucionet publike gjatë zgjedhjeve. Në zbatim të nenit 19 pika 1 është kompetencë e Komisionerit për tu kujdesur për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtëpërdrejtë të përpiktë dhe të saktë. Duke vlerësuar nga kjo pikëpamje objektet që trajton ky projektvendim vlerësohet se nga ana e ligjshmërisë është kompetencë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për tu shqyrtuar. Ky projektvendim ka si qëllim parandalimin e sjelljes apo përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe administratës shtetërore gjatë periudhës 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve. Po kështu ky projektvendim synon që funksionarët publike të çdo niveli nuk mund të përdorin direct apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjete sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale duhet të lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete. Gjithashtu, zbatimi i kësaj rregullore, pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik. Për sa më lart i paraqesim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, shqyrtimin dhe miratimin projektvendimi “Për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje”. I është dërguar për njohje partive politike dhe OJF-ve dhe ka pasur mendime të Partisë Socialiste dhe të Organizatës KRIIK. Partia Socialiste përsa i përket ndryshimit të këtij akti ose propozon më saktë ndryshimin që në titull të projektvendimit, gjithashtu edhe në përmbajtje mendon të paktën në lidhje me pikën 3 ku do të duhet të pasqyrohet konkretisht se cilat janë ndalimet e veprimtarive politike dhe elektorale dhe të shtohet edhe një pikë ku parashikohet dhe konstatohen kundrvatje administrative në rast se konstatohen shkelje që bien në kundërshtim me këtë akt. Përsa i përket organizatës KRIIK ka sygjerruar bërjen më të qartë të dallimit në këtë akt mes profileve personale dhe atyre zyrtare të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

faqeve publike në rrjetet sociale. Edhe disa sygjerime të tjera të cilat ne i kemi të pasyruara në aktin tonë.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë projektvendim? Po përfaqësuesja e Partisë Socialiste!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS-së: Faleminderit zoti Kryetar! Atëherë, për sa i takon aktit të përcjellë nga ana juaj kemi dërguar edhe nëpërmjet email zyrtar disa sygjerime sa i takon përmbatjes së projektaktit, duke menduar që sygjerime e përmirësojnë projektaktin dhe e sjellin më të qartë përpara institucioneve dhe funksionarëve publike për zbatimin e tij. Së pari konstatojmë se titulli i projektvendimit “rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje nuk gjen pasqyrim në vete përmbatjen e project aktit pasi vihet re se projektvendimi në vetvete parashikon ndalime jo vetëm për institucionet publike madje edhe për funksionarët publikë. Madje pika 1 e tij fillon pikërisht me funksionarët publikë. Gjithashtu nga ana tjetër konstatohet nga përmbatja e aktit se ndalimet në fakt i takojnë llogarive zyrtare në rrjetet sociale dhe jo mediat online në vetvetë kështu që në këto kushte do të sygjeroja që në përmbatje të titullit të projektaktit përveç institucioneve publike të përfshiheshin edhe funksionarët publik edhe media online të zëvendësohej me rrjetet sociale. Faleminderit, për sa i takon pikës së parë. Nga ana tjetër edhe siç dhe u lexua akti në vetvete duhet të përmbajë një dispozitë i cili të përmbajë parashikimet se shkelja e rregullave që miratohe dhe bëhen ndërruese në këtë akt, do të konsiderohen kundravatje administrative si dhe dispozita referuese e Kodit Zgjedhor për ndëshkimin e tyre me gjobë. Pra, kur e referon si shkelje dhe sa është masa ndëshkuese në rast shkelje të këtyre dispozitave. Dhe në pikën 3 të aktit sugjerojmë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.03.2025*


vetëm një rregullim të teknikës legislative ku veprimtaria politike të zëvendësohet me veprimtari partiake sepse i përmbahet vet frymës së aktit sepse ato referon që në fillim të tij për të qenë me të njëjtën gjuhë të teknikës legislative. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Përfaqësues të partive të tjera në lidhje me projekt aktin? Po përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. F. Nuri, përfaqësuesi i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner në parim jemi dakord me vendosjen e rregullave strikte për përdorimin e rrjeteve sociale nga kandidatët apo nga administrata në tërësi. Ne e kemi shprehur edhe herë të tjera kur kemi pasur raste lidhur edhe me denoncime rasti i fundit përpara pak ditësh, ku pikërisht kishte një konfuzion në përdorimin e rrjetit social të themi që një kryetari bashkie nga rrjeti social personal në faktin që përdorej edhe për aktivitete të themi të bashkisë konkrete. Por duke e përgjithësuar jemi të mendimit që këto rregulla duhet të implementohen dhe të jenë strikte dhe të bëhet një diferencë e qartë pikërisht se ku janë kufinj të përdorimit të rrjeteve sociale jo vetëm për titullarët e institucioneve por edhe për administratën në tërësi sepse duhet ti jepet fund njëherë e mirë praktikës së përdorimit apo le të themi keqpërdorimit të rrjeteve sociale qoftë nga specialist më i thjeshtë deri tek niveli më i lartë i administratës që i përdorin rrjetet sociale herë me detyrim herë pa detyrim rrjetet e tyre personale i përdorin për propagandë. Kështu që unë si përfaqësues i Partisë Demokratike i inkurajoj që të merren masa në këtë drejtim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë dakord duke vlerësuar çfarë u tha edhe nga përfaqësuesja e Partisë Socialiste dhe nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike por edhe çfarë është rekomanduar prej organizatës KRIIK, mendoj që meqenëse në parim të gjitha palët


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

janë dakord me nxjerrjen e një akti të tillë. Do të reflektojmë disa prej këtyre propozimeve të bëra tani por të bëra edhe më parë nga KRIIK. Po e drejtë do të bëjmë një ndryshim të projektaktit duke e përfshirë që në titull edhe funksionarët publik pasi edhe ata janë pjesë subjekt i trajtesës në këtë projektakt do të përfshijmë edhe pjesën e komunikimit online jo vetëm nëpërmejt rrjeteve sociale po faqe internet dhe të tjera komunikime online të institucioneve publike por edhe të funksionarëve publik, pra do ta përfshijmë edhe këtë ndryshim dhe ndërkohë në sygjërim të KRIIK nëse nuk gabojë do të përfshijmë, do të përcaktojmë ose do të japim edhe një përkufizim të llogarisë së funksionarit publik ose të institucioneve publike. Pra, për ta qartësuar disi më mirë se kush do të konsiderohet llogari e institucionit publik apo e zyrtarit publik dhe cila është ajo personale. Pra, do të vendosim një përkufizim të këtyre dy kategorive ose të njërës prej këtyre kategorive. Përsa i përket sanksioneve sikurse mund ta kuptoni ky nuk është një akt rregullator por është një akt i karakterit ekzekutiv i cili del në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator. Nuk mendoj që është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror për të vendosur rregulla në lidhje me sanksionet. Kështu që do të ngelemi vetëm tek këto ndryshime dhe përmirësime të projektaktit. Pra, miratimi do të bëhet me këto ndryshime, të cilat i listova. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:17**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për vlerësimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën
23 shkurt – 1 mars 2025”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z.F. Nuri), PS (znj.E.Xhina)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë të pika e dytë e rendit të ditës.

Znj. P.Doçaj: Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me vlerësimin me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 23 Shkurt – 1 Mars. Raportimin e veprimtarive publike këtë ndërfaqe pra në ndërfaqen NRI për periudhën 23 Shkurt-1 Mars konstatohet si vijon, 12 institucionet publike të reja janë rregjistruar në ndërfaqen NRI, 415 raportime janë kryer në total, 394 postime janë aktive, 21 veprimtari janë të ndaluara nga të cilat 10 veprimtari ne propozojmë që të fillojë shqyrtimi administrativ dhe për 11 veprimtari do të propozojmë për mos fillim të shqyrtimit, pasi janë veprimtari të cilat janë rihedhur dhe riraportuar brenda afateve ligjore në ndërfaqen NRI. KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të institucioneve shtetërore kryejnë raportime në lidhje me veprimtarinë publike që planifikojnë të

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

zhvillohen prej tyre të paktën 5 ditë përpara zhvillimit të tyre në përputhje me Kodin Zgjedhor. Bashkëlidhur edhe projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike diçka në lidhje me raportin? Nuk keni! Mirë, atëherë do të mbajmë komunikimin me institucionet publike të cilat do të duhet të japin shpjegime dhe informacione për sa përmbahet në këtë raport.

Vendimi nr. 233

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:18**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 23 shkurt – 1 mars 2025”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj.P.Doçaj, znj.I.Osmanaj, znj.L.Veliu**
- **Parti Politike:** **PD (F. Nuri), PS(znj. E.Xhina)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me raportin e monitoruesve po për periudhën 23 Shkurt- 1 Mars.

Znj. L. Veliu: Nga monitoruesit për periudhën 23 Shkurt-1 Mars 2025 janë dorëzuar gjithësej 96 raporte monitorimi pranë KQZ. Ky dorëzim përbën raportin e 6 të dërguar nga secili monitorues që nga fillimi i procesit të monitorimit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi që i është bërë raporteve të monitorimit për këtë periudhë kohore rezulton si më poshtë vijon: Janë evidentuar 25 aktivitete nga partitë politike dhe tre zyra të hapura për zhvillimin e aktiviteteve përgatitore të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për kuvend. Në përfundim nuk janë konsideruar shkelje nga monitoruesit e fushatës zgjedhore.

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Nuk kemi!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 7, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, Znj.I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tæk pika tjetër e rendit të ditës! Tek shqyrtimi i denoncimeve nr. 7, nr. 22, nr.23, nr.25, nr.27, dhe nr.28 të Partisë Demokratike shkurt për secilin prej tyre cila është përmbatja.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.7, denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Erion Veliaj. Është një çështje e mbartur në fakt ka të bëjë me konstatimin e shpërdorimit të burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Zoti Erion Veliaj me detyrë Kryetar i Bashkisë Tiranë, ka shpërndarë certifikata pronësie për familjet e prekura nga tërmeti i vitit 2019, në lagjen 5 Maji në kryeqytet. Gjithashtu në një dalje publike i Bashkisë Tiranë ka deklaruar në mënyrë publike se “Në shtator, Tirana do të jetë qyteti i parë në Shqipëri ku të gjithë nxënësit e shkollës 9-vjeçare, do të kenë drekën e përfshirë dhe do të qëndrojnë në shkollë deri në orën 16:00 pasdite. Është filluar procedimi

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

administrative nga ana jonë. Është njoftuar Bashkia Tiranë dhe sot është prezent dhe ka dërguar edhe pretendimet shkresërisht.


Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e bashkisë? Përpara se tiu jap fjalën juve përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka diçka për të shtuar?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar në lidhje me denoncimin numër 7 ne i kemi pasqyruar pak a shumë të gjithë elementët e shkeljeve të pretenduara nga ana jonë në kërkesë. Po është një denoncim i Partisë Demokratike kundër kryetarit në detyrë të bashkisë së Tiranës zotit Veliq për kryesisht për shpërndarjen e certifikatave të banorëve të lagjes 5 Maj në Tiranë, këtë deshëm të saktësonim që bëhet fjalë për certifikata pronësie të cilat bien ndesh pikën b të nenit përkatës ku shpërndarja e veprimtarive publike të akteve për rregjistrimin të tokës bujqësore, të certifikatave të pronësisë dhe çfarë do lloj tituli etj etj, këto janë në vlerësimin tonë katër muaj përpara zgjedhjeve duhet të jenë të ndaluar dhe përbëjnë shkelje. Sepse është përdorimi i burimeve publike që shfrytëzohet për aspektin politik dhe propagandistic. Kemi bashkëngjitur në denoncim edhe provat po themi linket nga burime të hapura ku janë pasqyruar rastet konkrete edhe nga mediat edhe nga burime të hapura nga ku janë marrë rastet në fjalë dhe i kemi vënë në dispozicion të KQZ-së. Nisur nga sa më sipër për ekonomi të procedurës kërkojmë marrjen e masave administrative përkatëse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve! Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po përfaqësuesja e Bashkisë Tiranë! Ju lutem emër, mbiemër.

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Atëherë, i nderuar përveçese e kemi nisur me shkrim po e nisim sipas kronologjisë që ka bërë denoncimin subjekti tjetër zgjedhor për shpërndarjen e certifikatave të pronësisë.


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

Shpërndarja e certifikatave të pronësisë është bërë për një process i cili vijon në mënyrë kronologjike prej 2020 e në vijim. Kemi të bëjmë me procesin e rindërtimit akti nr.9 e shpreh në mënyrë të qartë procedra që do të zhvillohet si dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij. Nis me aplikimin e subjekteve për të qenë përfitues, shpallen përfitues, lidhin aktmarrëveshje paraprake . Është bërë procesi i hedhjes së shortit në momentin i hedhjes së shortit bëhet aplikimi në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për daljen e certifikatës dhe jemi fiks në këtë moment pas hedhjes së shortit i cili ka ndodhur në mënyrë kronologjike në disa data të përcaktuara konkretisht shorti i parë në 25 Dhjetor 2021, shorti i dytë në 3 Mars 2023 e më pas me shortin e mbajtur në 23 Tetor 2024 dhe i fundit në 2 Dhjetor 2024. Pra, në mënyrë kronologjike ka ndodhur hedhja e shorteve në mënyrë të herë pas hershme, shpërndarja e certifikatave është një procedurë që është pas hedhjes së shortit, në momentin që hidhet shorti përcaktohet se cili apartament do jetë i subjektit përfitues. Bëhet aplikimi nga vetë njësia e qeverisjes vendore në ASHK për regjistrimin e pronësisë sipas aktit normative dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij në momentin e daljes së certifikatës bëhet kjo procedura e certifikatës. Pra, kemi të bëjmë siç edhe në udhëzuesin nr.9 të nxjerrë nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve është në nenin 3 pika 1 përcaktohet që veprimtaritë e ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkiufizimit të pikës 2 për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion. Në rastin konkret nuk jemi në një procedurë të ndodhur rishtazi apo posaçërisht në dispozicion. Jemi në një kronologji nga viti 2020 deri në vijim sot. Për sa i përket pikës së dytë që ka të bëjë me veprimtaritë e ndaluara për sa i përket investimeve në kuadër të arsimit publik. Bashkëlidhur qëndrimit tonë kemi depozituar edhe shpalljet të cilat publike ose nga portalet të cilat Kryetari i ka bërë që me 18-19 Dhjetor. Pra, jemi përpara katër mujorit për të cilat janë deklarata të ndaluara për shkak të zgjedhjeve. Përveç këtij fakti këto deklarata janë bërë në

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

mbledhjen e Këshillit Bashkiak në të cilin është miratuar programi buxhetor afat mesëm 2025-2027 në të cilën është një projektbuxhet i detajuar për rastin konkret që është një fond rezervë 1 miliard e 118 milion duke e rrumbullakosur për sa i takon shkollave të cilat do të përfitojnë ushqim për nxënësit. E cila është një projekt I cili do të filloj zbatimin nga Shtatori 2025. Pra edhe në rastin konkret po ti referohemi udhëzuesit në nenin 3 pika 1.1 e ka të përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat janë veprimtaritë të cilat janë vënë rishtazi apo në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas fondit buxhetor të miratuar. Edhe në rastin konkret nuk jemi në një veprimtari të ndaluar pasi veprimtaria për të cilën pala ankimuese shprehet se është e ndaluar është e miratuar në planin afat mesëm buxhetor si dhe është lançuar shumë kohë më përpara, se të jemi në këtë fazën në të cilën ndalohet nxjerrja dhënia e fondeve apo bëria e publikimeve të cilat ndodhin rishtazi për shkak të zgjedhjeve. Në rastin konkret nuk ndodhemi në këtë pikë siç edhe vetë udhëzuesi e parashikon. Përsa i përket pikës së tretë përdorimit të fondeve publike , siç edhe e shpjeguem në të dyja pikat në të dyja rastet më përpara nuk jemi në përdorimin e fondeve publike të krijuara rishtazi për të cilën është një periudhë e ndaluar por janë të miratuara shumë kohë më përpara. Edhe diçka tjetër për sa i përket çertifikatave të cilën e referova edhe më parë certifikatat në momentin që shpërndahen apartamentet, bëhet shorti publikë, më këto apartamente nuk janë asete të asnjë institucioni u shpërndahen dhe qytetarët e marrin edhe jetojnë atje. Porcesi i certifikimit nga momenti i shpërndarjes së apartamenteve deri në përfundimin e procesit të certifikimit që në momentin e kryerjes së aplikimit. apo gjykatat e kanë pranuar dhe ka vendime të tilla që ti je pronar që në momentin e bërjes së kontratës. Dhe në rastin konkret jemi në momentin që kemi bërë marrëveshje para prake bëhet shpërndarja e apartamenteve, përfitues apo pronar të këtij apartamenti janë subjektet përfitues dhe nuk janë më asete të bashkisë por janë prona të qytetarëve të cilët janë përfitues të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

cilët janë përfitues për të procesit të rindërtimit. Në të gjithë sa parashtruar më sipër shprehemi se nuk ndodhemi përpara veprimtarive të ndaluara të kryera nga ana e institucioneve publike kemi të bëjmë me një procedurë administrative e cila ka nisur kohë më përpara dhe po vijon është në vazhdimësi nuk ka ndodhur enkas për të cilën pala pretendon se jemi përpara veprimtarive të ndaluara.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni për të depozituar dokumentacion këtu?

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: I kemi depozituar me shkrim.


Z. I. Celibashi: Keni gjë tjetër?

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Jo, nuk kemi gjë tjetër ato janë.

Z. I. Celibashi: Në rregull! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar! Përfitojë edhe nga prapësimet e Bashkisë. Tiranë këtu në mbrotjen e tyre për të mbajtur një qendrim dhe për të pyetur përfaqësuesen e Bashkisë Tiranë në lidhje me çka tha. Atëhere, më lejoni të fokusohem pak tek pjesa e certifikatave të pronësisë meqenëse u përmend disa herë që certifikatat këtu kishin të bënin me hedhjen e shortit dhe u përmend termi rradhë, që është një farë rradhe, pyetja ime është: A është e parashikuar në ligj që shpërndarja e certifikatave të bëhet publikisht dhe të jepen në dorë nga kryetari i bashkisë? Është e parashikuar që kjo procedurë mbasi hidhet shorti po themi dhe rastësisht i bie rradha dikujt në këtë periudhë 4 muaj përpara

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*


zgjedhjeve për të marrë certifikatën. Është e parashikuar që ai person apo ato familje do ta marrin certifikatën publikisht nga kryetari i bashkisë?

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Fakti që diçka në ligj nuk është e parashikuar nuk është as e ndaluar. Në momentin që është aplikuar për certifikat pritja e daljes së saj ka një procedurë të përcaktuar të cilën e përcakton ligji 2020 për nxjerrjen e akteve të pronësisë dhe në rastin konkret mënyra se si jepet certifikata as është e parashikuar as është e ndaluar diku. Në momentin që del certifikata ajo do ti jepet atij qytetarit në dorë për të provuar faktin që ai është pronar i pronës sepse ka lidhur një akt marrëveshje paraprake dhe në këtë akt marrëveshje paraprake ka hequr dorë nga prona e mëparshme dhe që ky të vërtetohet që do jetë pronar i pronës.....

Z. I. Celibashi: Ndjesë që po iu ndëroresë, nuk po e diskuton njeri këtë çështje e mënyrës së kalimit të pronësisë nuk është kjo në diskutim fare, fare. Dhe nuk ka asnjë interes për procesin administrative se si realizohet marrja e pronësisë me çfarë akti etj etj si këto, kontrata për rata qytetarët. Diskutimi është nëse do të duhet të ishte event publik dhe a është event publik shpërndarja e këtyre certifikatave ky është diskutimi. Juve pak më para thatë që ajo çka është publike ka të bëjë me të gjithë procesin e shortimit të qytetarëve të cilët përftojnë nga ky process dhe në finalizim të saj është konkluduar që ai që I ka rënë shorti të themi është edhe pronari i saj është kështu apo është ndryshe?

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Më fal atij që i ka rënë shorti është pronari i saj sipas akteve ligjore. Por që të finalizohet kjo gjë ligji 2020 apo edhe akte të tjera qoftë edhe akti normativ. Akti normative nr.9 përcakton që

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

është njësia e vetqeverisjes vendore që do të përfundojë regjistrimin e procesit dhe nis me shpërndarjen fizikisht të apartamenteve siç është hedhja e shortit deri në certifikimin e saj. Momenti i dhënies së certifikatës është po procedurë publike për të thënë që po këta qytetarë e kanë marrë realisht këtë apartament për të thënë që këta qytetarët po përfitojnë nga procesi i rindërtimit për të thënë që këta qytetarët janë ndihmuar në të gjithë këtë process sepse ka qenë një process publik nga fillimi deri në fund. Marrja e certifikatës në dorë është finalizimi i të gjithë kësaj. Siç e shpreha më përpara hedhja e shortit është vetëm shpërndarja e apartamenteve fizike nga ai moment ai qytetar merr apartamentin është pronar i saj.....

Z. I. Celibashi: E kemi të qartë , faleminderit.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Mesa kam parë edhe tek rasti që ne kemi sjellë si provë, e depozituar në KQZ po është po themi burim mediatik këtu nuk flitet për short, por flitet sipas zotit Veliaj transformimi i kësaj zone ishte punë e përbashkët dhe nënvizoi se certifikata e pronësisë mund të kishin ndodhur dy tre vjet më parë por bllokimi i punës e bëri të pa mundur. Me sa kuptoj nga ky raportimi i kësaj media ka qenë problem bllokim punimesh të paktën sipas kryetarit të bashkisë dhe jo çështje shorti. Por rastësia e bëri që këto certifikata publikisht të shpërndahen pas 11 Janarit. Pyetja edhe Komisioneri e ri formualoi po ajo është thelbi që ne duam të ngremë dhe shqetësimi ynë nuk është tek transparenca e procesit në vetvete. Shqetësimi ynë është që këto ngjarje po përdoren politikisht dhe prandaj bëhen të gjitha këto evente publike me media me rradhë, ku po shpërndahen certifikatat nga vetë dora e kryetarit të bashkisë. Kur fare mirë nuk është e parashikuar në ligj një gjë e tillë dhe ne gjykojmë se ky event publik me këtë lloj shfaqje me dhënien e certifikatave publike disa personave të caktuar është shkelje sepse nuk duhet të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

ndodhi 4 muaj përpara zgjedhjeve. Deri më 11 Janar mund të kishin ndodhur dhe nuk do të ishim ankuar mbas datës 11 Janar sikundër ka ndodhur edhe në këtë rast bëhet fjalë për datën 17-18 Janar është publikimi në media ne gjykojmë që bën pjesë tek kjo shkelje. Për i përket shkollave meqenëse u përmend dhe ne nuk u fokusuam gjatë aty, një pyetje për përfaqësuesen e Bashkisë së Tiranës meqenëse u citua se bëhej fjalë për një fond të miratuar nga Këshilli Bashkiak mund të na e jepni pak datën se kur është miratuar ky fond në vitin 2025 ka qenë përpara apo pas 11 Janarit? Faleminderit!

Znj. Altemira Petanaj, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë: Atëhere, po e nis nga pjesa e fundit që është miratimi i buxhetit, për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2025-2027 është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.181 datë 18.12.2024. Pra, jemi shumë kohë më përpara se pala pretendon. Portalet mund të japin lajmë përditë por fakti se kur ka ndodhur realisht është datë 18.12.2024, që nuk kemi të bëjmë fare me pjesën e veprimtarive të ndaluara.

Z. I. Celibashi: Dakord! Kemi gjë tjetër?! E përfundojmë hetimin administrative të kësaj çështje. Nëse nuk keni dokumentacion tjetër për të depozituar. Për vendimin do të njoftoheni në ditët në vijim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:36**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 22,
datë 18.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F.Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek denoncimi nr.22!

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.22, denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Pjerin Ndreu, Kryetar në Bashkinë Lezhë. Objekti i denoncimit është konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor Partia Demokratike pretendon se Bashkia Lezhë ka shpallur procedurat e prokurorit për sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve rurale në administrim të Bashkisë Lezhë para fushatës zgjedhore. Është filluar hetimi administrativ nga ana jonë në datën 20.02.2025 kemi administruar edhe pretendimet e Bashkisë Lezhë të cilët theksojnë se Bashkia Lezhë në përmbushje të funksioneve dhe detyrave të saj po realizon investime në infrastrukturën publike rrugore të parashikuara në buxhetin e vitit 2025. Për këtë motiv bashkia pretendon se nuk është në kushtet e ndalimit të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Janë ftuar por nuk është prezent

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

asnjë nga përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë. Pra, përveç pretendimeve nuk kanë të depozituar asnjë provë tjetër dhe nuk janë paraqitur.

Z. I. Celibashi: Domethënë kanë dhënë shpjegime, por dokumentacion provues nuk kanë. Mirë do ta shtyjmë do ti kërkojmë që të depozitojnë pranë KQZ-së dokumentacionin provues të pretendimeve të tyre.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:37**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 23,
datë 18.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ:** **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F.Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Tek shqyrtimi i denoncimeve nr. 23,

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.23, denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Edi Rama në cilësinë e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Objekti i denoncimit ka të bëjë Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me një deklaram Kryeministri i Shqipërisë ka deklaruar se nëpërmjet një bashkëpunimi midis Bankës Qendrore, bankave të nivelit të dytë dhe Qeverisë do të mundësohet kreditimi në sektorin bujqësor për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kryeministri është shprehur se nëpërmjet kombinimit të financimit nga Banka e Shqipërisë dhe mbështetjes së Qeverisë, të quajtur sipas tij “garancia sovrane” do të mbulohet 70% e principalit të kredisë që do të aplikohet nga fermerët dhe sipërmarrësit në sektorin bujqësor. Në kuadër të hetimit

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

administrativ i jemi drejtuar Kryeministrisë nëpërmjet email për të kërkuar pretendimet e tyre. Na kanë kërkuar kohë për të dërguar pretendimet dhe provat përkatëse . Sot nuk janë prezent edhe pse janë njoftuar.

Z. I. Celibashi: Do ta shtyjme edhe këtë rast, në pritje të pretendimeve nga zyra e Kryeministrit.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

administrativ i jemi drejtuar Kryeministrisë nëpërmjet email për të kërkuar pretendimet e tyre. Na kanë kërkuar kohë për të dërguar pretendimet dhe provat përkatëse . Sot nuk janë prezent edhe pse janë njoftuar.

Z. I. Celibashi: Do ta shtyjme edhe këtë rast, në pritje të pretendimeve nga zyra e Kryeministrit.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:38**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “ Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 25,
datë 18.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike ”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z.F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Tek shqyrtimi i denoncimit nr. 25.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.25, denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Agron Malaj në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mat. Objekti i denoncimit ka të bëjë me konstatimin e kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me disa veprime që këshilli bashkisë ka kryer sipas tyre është mbledhur me 07.02. në orën 10:00 dhe ka miratuar në rendin e ditës pikat si më poshtë: Shqyrtim dhe miratim i numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025; Shqyrtim dhe miratim i pagave të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025; Shqyrtim dhe miratim i përfituesve të programit të strehimit “Subvencion i qirasë” për 32 familje në nevojë; Është filluar hetimi administrative nga ana jonë.Kemi administruar edhe pretendimet e personit përgjegjës të Bashkisë

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

Mat. Janë thërritur edhe janë prezent sot.

Z. I. Celibashi: Përpara se ti japim fjalën përfaqësuesit të Bashkisë Mat, ka diçka për të shtuar më shumë përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Në lidhje me këtë denoncim i nderuar ne duam të fokusohemi që nga 4-5 pikat e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 07.02.2025 synimi dhe fokusi ynë ka qenë sa i takon subvencionimit të qerasë. Për një kategori të caktuar familjesh, duke qenë se ka ndodhur pas datës 11 Janar, pra në periudhën 4 mujore përpara zgjedhjeve për të cilat ne mendojmë që mbështetja promovimi, miratimi i akteve me karakter ekonomik-social që synon dhënien e ndihmave për një kategori të caktuar personash është veprimtari publike e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 /2020 të Komisionit Rregullator, ndaj për këtë kërkojmë marrjen e masave administrative përkatëse.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Bashkisë Mat, emër mbiemër ju lutem!

Z. Eduart Abazi, Drejtor i Çështjeve Ligjore: Përfaësoj Bashkinë Mat në bazë të autorizimit paraqitur stafit të KQZ-së. Atëherë nga subjekti Partia Demokratike është kryer denoncimi i datës 17.02.2025 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në të cilën kërkojmë sa citojmë: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet miratimit të akteve të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për një kategori të caktuar personash nga Bashkia Mat.”, me pretendimin se Këshilli i Bashkisë Mat në mbledhjen e datës 07.02.2025, ora 10.00 ka miratuar rendin e ditës dhe ndër të tjera Shqyrtim dhe miratim i përfituesve të programit të strehimit “Subvencion i qirasë” për 32 familje në nevojë. Ku parashton se, citojmë: “Mbështetja, promovimi dhe miratimi i akteve me karakter social të cilat synojnë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

dhënien e ndihmave për një kategori të caktuar personash është veprimtari publike e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator... Në kuptim të kësaj dispozite, paratë që do të përdorë Bashkia Mat për të subvencionuar qiratë e familjeve në nevojë konsiderohen burim publik dhe Bashkia Mat po i përdor ato para fushatës zgjedhore... Për sa më sipër, vlerësojmë se ndërmarrja e këtyre veprimeve nga ana e Bashkisë Mat para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i kësaj veprimtarie është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe mobilizimin e votave të zgjedhësve... Në nenin 91 Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale etj. KQZ-ja nxjerr udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike. Në Kreun II “Kategoritë e veprimtarive publike të ndaluara”, neni 3 “Veprimtari të ndaluara” pika 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator përcaktojmë, se citojmë: Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale. Në pikën 5 thuhet se: Në zbatim të


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

ndalimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave marrin masa për të mosvendosur ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3 të këtij neni...” Referuar dispozitave të sipërcituara, rezulton se, Këshilli i Bashkisë Mat nuk ka miratuar asnjë akt administrativ në shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, ku më hollësisht parashtrijmë: Referuar dispozitave të sipërcituara, rezulton se, Këshilli i Bashkisë Mat nuk ka miratuar asnjë akt administrativ në shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ku më hollësisht parashtrijmë: Subjekti, Partia Demokratike në mënyrë të gabuar i referohet përcaktimeve të pikës 1.1 gërma b, të nenit 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, pasi në rastin konkret nuk jemi përpara veprimtarive publike që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;”, por kemi të bëjmë me dhënie e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, siç është rasti konkret të mbështetjes ekonomike për individët/ familjet me statusin “I pastrehë” të cilët përfitojnë nga programet sociale të strehimit, ku një nga instrumentet e programit të banesave sociale me qira është Subvencionimi i qirasë, veprimtari kjo që trajtohet në pikën 3 të nenit 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së. Së dyti: Në interpretim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, përkatësisht në parashikimet e nenit 91 pika 4 e ligjit Nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 3 pika 3 dhe 5 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 ku ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: Katër muaj para


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, pra arrihet në konkluzionin se qëllimi i këtyre dispozitave, është ndalimi i nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore që në rastin konkret ka të bëjë me dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë mbështetje ekonomike nga organet/ entet publike në nivel qendror, pasi ndalimi lidhet me periudhën deri në formimin e qeverisë së re, pra, që ka të bëjë me ndalimin e kompetencave në këto fusha veprimtarie të qeverisjes qendrore dhe jo asaj vendore, ku kjo del në pah në përcaktimet e pikës 5 të nenit 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, në të cilin përcaktohet se, citojmë si më lartë: Në zbatim të ndalimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave marrin masa për të mosvendosur ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3 të këtij neni.”Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se, fondet për programet e strehimit janë në zbatim të ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, ku me shkresën me Nr.Prot.15900, datë 18.12.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025” të Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bashkia Mat është vënë në dijeni mbi hapjen e thirrjes për projekte të reja për programet e strehimit për vitin 2025, ku një ndër programet është dhe programi i banesave sociale me qira nëpërmjet instrumentit “Subvencionimi i qirasë”, dhe se bashkëfinancimi i bashkisë Mat për këtë program është miratuar me VKB Nr.93, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Mat të vitit 2025”, pra, ndryshe nga sa pretendohet nga subjekti, Partia Demokratike, ndërsa me VKB Nr.13, datë 07.02.2025 “Për miratimin e 32 familjeve përfituese të programit të strehimit social “Subvencion i Qirasë” dhe


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

shumën e bashkëfinancimit” që citohet nga subjekti, Partia Demokratike është miratuar lista e përfituesve të individëve/familjeve me statusin “I pastrehë” cilët kanë aplikuar për këtë program strehimi “Banesa Sociale me Qira”. Për sa më lart, vërtetohet fakti se, Vendimi i Këshillit të Bashkisë me Nr.13, datë 07.02.2025 “Për miratimin e 32 familjeve përfituese të programit të strehimit social “Subvencion i Qirasë” dhe shumën e bashkëfinancimit” nuk bën pjesë në aktet administrative të ndaluara për t’u miratuar/ nxjerrë në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 pika 3 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, pasi Këshilli i Bashkisë është organ përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore në kuptim të nenit 7 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), dhe jo i qeverisjes qendrore, si dhe vërtetohet fakti siç parashtruar më lart se fondet e financimit të ministrisë dhe bashkëfinancimit të bashkisë Mat janë miratuar me buxhetet e vitit 2025, përpara periudhës 4-mujore para datës së zgjedhjeve. Dhe në lidhje me 2 Projekt – Vendimet e tjera të cilat janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë Mat në mbledhjen e datës 07.02.2025, edhe pse nuk janë objekt denoncimi nga subjekti, Partia Demokratike, ju parashtrojmë se: Projekt – Vendimi për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025, është kryer përpara ndalimit që përmban nenit 91, pika 3 të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 3, pika 1.3, gërma “d” të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, në të cilat përcaktohet se, ndalimi i marrjes në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura është vetëm gjatë fushatës zgjedhore, ku fushata zgjedhore në kuptim të nenit 77 të Kodit Zgjedhor është për periudhën, fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Pra, dhe miratimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve nuk ndalohet nga përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituar, pasi nuk gjendemi në periudhën e fushatës zgjedhore. Projekt – Vendimi

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

për miratimin e pagave të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025, dhe në lidhje me miratimin e këtij projekt – vendimi, jemi përpara faktit ku ndalimi sipas përcaktimeve të nenit 91 pika 4 e “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 3 “Veprimtari të ndaluara” pika 3 dhe 5 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, është për organet e qeverisjes qendrore, dhe jo për organet e qeverisjes vendore, siç është Këshilli i Bashkisë Mat. Bashkëlidhur kundërshtimeve ju dërgojmë provat shkresore si më poshtë: Shkresa me Nr.Prot.15900, datë 18.12.2024 të Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Email-i i datës 04.02.2025 dërguar nga punonjësi i Drejtorisë së Strehimit ku ndër të tjerash kërkohet dhe VKB për miratimin e listës emërore. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Mat me Nr.13, datë 07.02.2025 “Për miratimin e 32 familjeve përfituese të programit të strehimit social “Subvencion i Qirasë” dhe shumën e bashkëfinancimit. Shkresa me Nr.Prot.307/1, datë 24.01.2025 “Kthim përgjigje shkresës nr. 200 prot., datë 15.01.2025” të KQZ-së. Përfundimisht, për sa parashtruam më lart, vërtetohet se bashkia Mat nuk ka kryer veprimtari të ndaluara në kuptim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, dhe se pretendimet e subjekti politik “Partia Demokratike” janë të pabazuara në ligj, fakte e prova, ku i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pas shqyrtimit administrativ i veprimtarive publike të bashkisë Mat, të vendosë: pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Mat, ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni diçka për të shtuar?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Jo, nuk kemi gjë për shtuar, thjesht i qëndrojmë atyre kërkesave tona dhe përfundimisht kërkojmë pranimin e kërkesës i nderuar. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Keni dokumente shtese për të depozituar? Përveç atyre që keni dorëzuar shtesë nuk keni! Mirë faleminderit! Përfundojmë edhe për këtë denoncim hetimin administrativ. Do të vlerësojmë çfarë u pretendua nga secila prej palëve dhe dokumentacionin përkatës dhe do të marrim vendimin, i cili do tju njoftohet nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 11:51**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “ Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 27,
datë 18.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike ”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F.Nuri), PS (znj. E. Xhina)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Tek shqyrtimi i denoncimit nr. 27.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr. 27 denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Agron Malaj në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Mat. Objekti i denoncimit ka të bëjë me konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara sipas vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet shpalljes së njoftimit “Ftesë për ofertë” për shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me një procedurë të shpallur nga Këshilli i Bashkisë Mat në lidhje me e prokurimin për një shërbim publik dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale para fushatës zgjedhor. Përfaqësuesi i Bashkisë Mat është prezent, ka paraqitur pretendimet me shkrim edhe shkresat përkatëse

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*


Z. I. Celibashi: Ka diçka për të shtuar më shumë përfaqësuesi i Partisë Demokratike në lidhje me këtë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Në vazhden e denoncimit të parë edhe ky denoncim ka të bëjë pak a shumë me të njëjtin ndalimin e veprimeve të caktuara katër muaj përpara zgjedhjeve pra, për ekonomi të procedurës administrative nuk po ripërsërisim ato argumenta që i kemi shtjelluar këtu me shkrim dhe provat që i kemi sjellë bashkëlidhur. Mendojmë që edhe në këtë rast vërtetohet shkelja dhe kërkojmë marrjen e masës administrative nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Bashkisë Mat!

Z. Eduart Abazi, Drejtor i Çështjeve Ligjore: Po i nderuar faleminderit! Do të citojë përpara jush kundërshtimet që kemi ndaj pretendimeve, me të vërtet është ekonomizimi i seancës por duhet të nxjerrim në pah denoncimet e pa baza që sjell Partia Demokratike. Faleminderit! Subjekti Partia Demokratike në datën 17.02.2025 ka paraqitur denoncimin në të cilën kërkohet se Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara sipas vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet shpalljes së njoftimit “Ftesë për ofertë për shërbim pulikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale, me pretendimet se citojmë: Shpallja e procedurave të prokurimit publik 4-muaj para fushatës zgjedhore është veprimtari e ndaluar sipas Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Neni 3 pika 4 e Vendimit nr.9/2020 i Komisionit Rregullator parashikon: “4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/ partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të


*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor". Për këto arsye, vlerësojmë se shpallja e kësaj procedure nga ana e Bashkisë Mat para fushatës zgjedhore është veprim i kryer në shkelje flagrante të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator. Qëllimi i kësaj procedure është tërësisht politik dhe lidhet me zgjedhjet për kuvend të datës 11 Maj 2025 dhe mobilizimin e votave të zgjedhësve. Ndryshe nga sa parashtrohet subjekti, Partia Demokratike në denoncimin e saj drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), zhvillimi i procedurave të prokurimit nuk konsiderohen si "Veprimtari të ndaluara" sipas përcaktimeve të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe Bashkia Mat nuk ka kryer asnjë veprim në shkelje të këtij vendimi, ku më hollësisht parashtrahet: Referuar përcaktimeve të nenit 3 "Veprimtari të ndaluara" të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në asnjë dispozitë nuk ndalohet zhvillimi i procedurave të prokurimit, ku ndalimi i vetëm është ai i "promovimit" nenit 3 pika 1, nën-pika 1.1, në rast se fondet publike për zhvillimin e procedurave të prokurimit nuk janë sipas planit buxhetor të miratuar, por janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve. Në dispozitën e nenit 3 pika 4 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i KQZ, që i referohet subjekti, Partia Demokratike, sanksionohet se, citojmë: "Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncensionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen etj... Ndërsa kontrata e shpallur nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat me objekt: "Shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale", nuk është/ konsiderohet kontratë publike të koncesionit/ partneritetit publik privat (PPP), pasi këto të fundit zhvillohen dhe jepen sipas ligjit Nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" (i ndryshuar), por është kontratë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

publike e prokuruar nëpërmjet procedurave të prokurimit ku dhënia e saj rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), dhe aktit nënligjor Udhëzimit Nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” (i ndryshuar) të Agjencisë së Prokurimit Publik, pasi referuar vlerës së fondit limit prej: 318,900 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH, konsiderohet procedurë prokurimi me vlerë të vogël. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon subjekti denoncues, Partia Demokratike, shpallja e kësaj procedure prokurimi gjatë kësaj periudhe 4 (katër) mujore, nuk ka aspak lidhje me fushatën zgjedhore, dhe më tej qëllimi i saj të jetë politik i lidhur me zgjedhjet, pasi: Procedura e prokurimit me Vlerë të Vogël me objekt: “Shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale” është procedurë prokurimi që zhvillohet me vite në bashkinë Mat, pasi është një shërbim i nevojshëm për veprimtarinë që ushtron Bashkia Mat, bazuar në parimet dhe funksionet që ushtron si njësi e vetëqeverisjes vendore në bazë të ligjit organik Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ku nëpërmjet medias lokale kryen publikimet e njoftimeve për banorët e bashkisë Mat si në lidhje me procedurat administrative që ajo zhvillon, ku pjesë e tyre janë dhe banorët e kësaj bashkie (siç janë: njoftime për regjistrime në çerdhe, kopshte etj., njoftime për shërbime që duhet të kryejnë aplikime (programe strehimi etj.), njoftime për organizime dhe takime etj.) dhe pasqyrimin e veprimtarive që bashkia Mat kryen në kuadër të funksioneve që ushtron në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, sociale, kulturës, sportit etj., ku qytetarët duhet të jenë të informuar mbi veprimtaritë që zhvillohen në këto fusha. Pra, vërtetohet se, ndryshe nga sa spekulohet në mënyrë keqdashëse, zhvillimi i kësaj procedure prokurimi për kontraktimin e një media lokale për kryerjen e shërbimit të publikimit dhe pasqyrimin të veprimtarive të bashkisë Mat nuk ka qëllime politike për fushatën zgjedhore, dhe se fakt tjetër është se kjo

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

proçedurë ka vite që zhvillohen nga bashkia Mat, si në vite kur ka patur zgjedhje qëndrore/ vendore ashtu dhe kur nuk ka patur, si në periudha kur kryetarët kanë qënë të subjektit politik të Partisë Demokratike, ashtu dhe të Partisë Socialiste (bashkëlidhur kontrata Nr.Prot.1793, datë 13.07.2018 nënshkruar nga kryetari i bashkisë të subjektit politik të Partisë Demokratike). Proçedura e prokurimit me Vlerë të Vogël, me Nr.REF-37801-02-11-2025, me objekt: “Shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale” dhe me fond limit në vlerën: 318,900 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH, e zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mat më datë 12.02.2025, proçedurë të cilës i referohet subjekti denoncues, Partia Demokratike, është një proçedurë e zhvilluar konform legjislacionit për prokurimin publik, ku vlera e fondit për këtë proçedurë është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Mat, me Nr.93, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Mat të vitit 2025”, pra fondi i saj nuk është miratuar rishtazi apo posaçërisht në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve (edhe pse ky ndalim ka të bëjë me promovimin), që të kishte qoftë dhe një dyshim që po kryhet në kuadër të fushatës zgjedhore, si dhe fakti se u zhvilluar në periudhën Shkurt 2025, është pasi fondet për këtë shërbim janë të miratuar në buxhetin e vitit 2025, si dhe kontrata e shërbimit ekzistuese me Nr.Prot.687/7, datë 29.02.2024 përfundonte më datë 28.02.2025, pra, me qëllim moslënien e bashkisë Mat pa këtë shërbim u proçedua me zhvillimin e proçedurës përpara përfundimit të afatit të kontratës së mëparshme. (bashkëlidhur kontrata e mëparshme e shërbimit me Nr.Prot.687/7, datë 29.02.2024). Për sa më lart, vërtetohet fakti se, shpallja e proçedurës së prokurimit me Vlerë të Vogël me objekt: “Shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale” nuk bën pjesë në ato veprimtari të ndaluara sipas nenit 3 pika 4 të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i KQZ, pasi nuk është kontratë që jepet mbi bazën e proçedurave të koncesionit/ partneritetit

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

publik privat (PPP), si dhe nuk është zhvilluar për qëllime të fushatës zgjedhore, pasi është një shërbim që kontraktohet çdo vit nga bashkia Mat në bazë të nevojave që ka për këtë shërbim në kuadër të funksioneve që ushtron në zbatim të ligjit. Bashkëlidhur kundërshtimeve ju dërgojmë provat shkresore si më poshtë: Shkresa me Nr.Prot.132, datë 10.01.2025 “Dërgim Shtesë Rregjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2025” Kontrata Nr.Prot.1793, datë 13.07.2018 me objekt: “Media lokale dhe shërbime të ndryshme e nënshkruar nga ish-kryetari i bashkisë të subjektit politik të Partisë Demokratike. Si dhe kontratën e mëparshme për të cilën prandaj e kemi shpallur procedurën e prokurimit përpara se të përfundonte kontrata e mëparshme. Përfundimisht, për sa parashtroam më lart, vërtetohet se bashkia Mat nuk ka kryer veprimtari të ndaluara në kuptim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së dhe se pretendimi i subjektit politik “Partia Demokratike” është i pabazuar në ligj, fakte e prova, ku i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pas shqyrtimit administrativ i veprimtarisë publike të bashkisë Mat, të vendosë: Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Mat. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Ka diçka për të shtuar nga ana e Partisë Demokratike?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Jo, i nderuar nuk kemi gjë për të shtuar.

Z. I. Celibashi: Keni dokumentacion tjetër që do të paraqesni shtesë përveç atij që keni paraqitur?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

Z. Eduart Abazi, Drejtor i Çështjeve Ligjore: Jo, i nderuar i kemi paraqitur.

Z. I. Celibashi: Në rregull faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

**04.03.2025
Ora 12:00**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 28,
datë 18.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike ”.**


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Tek shqyrtimi i denoncimit nr. 28

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.28 denoncues është Partia Demokratike, subjekti i denoncuar është zoti Vangjel Tavo në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Himarë. Objekti i denoncimit ka të bëjë konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) është publikuar njoftim për shpalljen e procedurave të prokurimit me këto të dhëna: Autoriteti/enti kontraktor: Bashkia Himarë; Lloji i procedurës së prokurimit: Objekti i kontratës: Rikonstruksioni i Rrugës Horë Vranisht – Vranisht, zgjatja e kontratës 12 muaj.Është filluar procedimi i hetimit administrativ nga ana jonë në datën 22.02. 2025. Kemi administruar pretendimet e palës në email të cilët kundërshtojnë denoncuesin duke theksuar se fillimi i kësaj procedure ka filluar më

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

05.12. 2024 është njoftuar në buletin e njoftimeve publike në datën 10. 12.2024 dhe hapja e ofertave është bërë me 27.12.2024. pra, procedura ka kaluar të gjitha hapat ligjore administrative dhe aktualisht ndodhet në fazën e lidhjes së kontratës. Është një procedurë e bërë përpara fillimit të afateve të ndalimit sipas ligjit. Janë administruar vetëm pretendime dhe jo prova dhe bashkia nuk është prezent sot, pavarësisht se është njoftuar.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kanë kërkuar për shtyrje?

Znj. P. Doçaj: I kemi kërkuar email, na kanë dërguar vetëm email me pretendimet dhe na kanë thënë që provat do ti vendosin në dispozicion në ditët në vazhdim.

Z. I. Celibashi: Mirë, do ta shtyjme në pritje të paraqitjes së provave.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

04.03.2025
Ora 12:01

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 24, datë 19.02.2025, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. P.Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës me denoncimin e organiztës KRIIK.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket denoncimit nr.24 denoncues është KRIIK, subjekti i denoncuar është zonja Zhaneta Beqiri në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës së Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Tiranë . Objekti i denoncimit lidhur me raportimin e pa plotë të një veprimtarie nga ana e Drejtorisë së Kopshteve dhe Çerdheve Tiranë dhe përdorim i burimeve publike. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë më datën 10 shkurt 2025, është zhvilluar në Tiranë një aktivitet për inagurimin e Kopshtit nr. 74, “Luleborë”. Sipas raportimit në faqen e KQZ-së, folës kryesor në këtë aktivitet ka qenë z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe pjesëmarrës jo diskutant zj. Zhaneta Beqiri, Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.03.2025*

së Kopshteve dhe Çerdheve. Ku konstatohet pjesëmarrja në cilësinë e folësve të dy deputetëve të Kuvendit të zgjedhur në Qarkun Tiranë, z. Plarent Ndreca dhe zj. Ermonela Felaj nuk është deklaruar nga këta dy të fundit. Është filluar hetimi administrative me datën 22.02.2025. Kemi administruar në këtë rast edhe pretendimet e Drejtorisë së Kopshteve dhe Çerdheve nga të cilat konstatojmë se: në lidhje me aktivitetin mbi inagurimin e kopshtit Nr.74 “Luleborë”, ju bëjmë me dije se, ky aktivitet dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje me inagurimet e çerdheve dhe kopshteve publike të Bashkisë Tiranë, janë evente që organizohen nga Bashkia Tiranë, përkatësisht Drejtoria e Protokollit dhe e Ceremonialit Zyrtar. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, person juridik më vete, por institucion varësie e Bashkisë Tiranë në këto evente ftohet si pjesëmarrëse. Duke qenë se nuk kemi administruar prova sepse na kanë thënë që do na vendosin në dispozicion edhe ftesës, pra që thjesht kanë qenë të ftuar dhe nuk kanë qenë organizator dhe nuk mbartin detyrime për këtë të fundit. Mendojmë që do ta shtyjme edhe në këtë rast sepse na kanë kërkuar kohë për depozitimin e ftesës së organizatorit. Nuk janë present në ditën e sotme.

Z. I. Celibashi: Dakord! Mirë, faleminderit! Arëhere, në pritje të shpjegimeve shtesë edhe të dokumentacionit, do ta shtyjme për një ditë tjetër shqyrtimin e kësaj çështje. Mirë çështje të tjera në rend dite nuk kemi. Diskutime të tjera nuk kemi. Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

